



## Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka  
National Agency for Protection of Personal Data



### Kriteret Themelore të Vëzhgimit me Kamerë

*Kontrolluesi i të dhënave, në radhë të parë, duhet të njoftojë Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale rreth operimit të përpunimit para instalimit fizik të kamerave. Duhet definuar qëllimi i qartë dhe specifik, i cili mendohet të jetë proporcional me të drejtat në privatësinë e individit.*

*Vëzhgimi me kamera mund të shërbejë për një numër qëllimesh të ndryshme.*

*Gjersa shumica e sistemeve janë instaluar për një qëllim legjitim të sigurisë, ASHMDHP ka zhvilluar një hulumtim, fillimisht sipërfaqësor përmes zhvillimit të kontroleve të rasteve ku ka pasur abuzim flagrant, me ç'rast parakushtet dhe kërkesat relevante të mbrojtjes së të dhënave janë anashkaluar apo mospërfillur.*

*Individët kanë të drejtën e qenësishme për të qenë të informuar rreth përpunimit të të dhënave personale me mjete të vëzhgimit me kamera.*

*Është praktikë e përgjithshme që të jepen informata përmes njoftimeve të ngjitura në vende të dukshme dhe lehtësisht të qasshme brendapërbrenda hapësirës së monitoruar me anë të vëzhgimit me kamerë. Shenja paralajmëruese përmbanë shenjën e qartë të kamerës, mbishkrimin rreth vëzhgimit në gjuhët zyrtare të aplikueshme në nivel qendror dhe lokal, hapësirën e rezervuar për të dhënat e kontrolluesit (si, adresën, e-mailin, telefonin, etj), si dhe llogon e autoritetit për mbrojtjen e të dhënave personale (ASHMDHP).*

*Kontrolluesit të të dhënave nuk i lejohet të përdorë pamjet e kamerave për qëllime tjera, veç atyre të shpallura nga Agjencia, respektivisht Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Për shembull, nëse një organizatë do ta kishte shpallur qëllimin për instalimin e kamerave për arsye të sigurisë së objektit, kontrolluesi nuk ka të drejtë t'i përdorë ato pamje për ta kontrolluar praninë apo përqëndrimin e punonjësve në vendin e punës.*

*Kjo mund të legjitimizohet vetëm me kusht që ta njoftojë paraprakisht Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për qëllimin shtesë, si dhe me kusht që t'i informojë paraprakisht të gjithë punonjësit për një veprim të tillë.*

*Çdo person ka të drejtë të kërkojë qasje në informatat personale të përpunuara nga sistemi i vëzhgimit me kamera.*

*Meqë kontrolluesi i të dhënave nuk obligohet të ofrojë qasje fizike të drejtpërdrejtë në inçizime, procesi mund të lehtësohet duke ftuar individët e interesuar për të shikuar pamjet relevante pa e zbuluar identitetin e palëve të treta.*

*Efektet mjegulluese të pamjeve të caktuara janë gjithmonë të rekomandueshme! Instalimi i kamerave në dhomat e zhveshjes, ashensorë, hapësira sanitare, hapësirat e maternitetit, repartet e rehabilitimit të psikiatrisë, etj., mund të çojë në ndërhyrje të pavend në sferën private të individit dhe si i tillë është rreptësisht i ndaluar. Pavarësisht nga kjo, qëllimi mund të arrihet, për shembull, duke instaluar kamera jashtë hyrjes së këtyre hapësirave, duke ia përshtatur kështu mjetet adekuate dhe më pak të bezdisshme të përpunimit.*

*Kamerat e maskuara gjithashtu i nënshtrohen vlerësimeve të privatësisë. Askush nuk mund ti shfrytëzojë kamerat e maskuara dhe të marrë kompetencat e zbatimit të ligjit në përpjekje për të zbuluar një veprimtari të paligjshme, siç është vjedhja, pa e përfshirë policinë. Autoritetet e zbatimit të ligjit janë të ngarkuara me kompetenca ekzekutive për t'i hetuar dhe ndjekur këto shkelje.*

*Në rrethana normale, periudha kohore prej gjashtë muajsh konsiderohet e mjaftueshme dhe e arsyeshme për të mbajtur inçizimet nga vëzhgimi me kamerë. Pas skadimit të kësaj periudhe kohore të paracaktuar, pamjet duhet të fshihen automatikisht.*

*Në rastet kur një kompani sigurimi mbanë pmajet në emër të kontrolluesit të të dhënave, kontrolluesi obligohet ta administrojë marrëdhënien përmes një marrëveshjeje ligjore. Një marrëveshje e këtillë duhet të specifikojë që kompania e sigurimit do të veprojë vetëm sipas udhëzimeve të kontrolluesit dhe do të zbatojë të gjitha masat e duhura teknike të sigurisë ndaj përpunimit të paligjshëm.*

*Edhe pse Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale parasheh aplikimin e vëzhgimi me kamera nëpër apartamente, instalimi i një sistemi të këtillë duhet ti nënshtrohet kriterëve të pajtueshmërisë së 70% të banorëve, pastaj që ky veprim të arsyetohet me aspektin e sigurisë së banorëve dhe të pronës, të mos i nënshtrohet transmetimit dhe hapësira e vëzhguar të mos tejkalojë hyrjen e objektit dhe hapësirat e konsideruara si të përbashkëta.*